

VENDIM
Nr.298, datë 14.4.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.212, DATË 7.4.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI I
RISTRUKTURIMIT TË AEROPORTIT “NËNË TEREZA” SHA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.212, datë 7.4.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 38 811 252 (tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve.”.

2. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 15.7.2011.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha